




REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE	
ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	Nr. Prot.
Dep.	B/Prot.
Dep. <u>2-D</u>	Prot. No. <u>01-167/16</u>
Nr. I fau	Data
Broj stranica	Datum
Nr. pages <u>02</u>	Date <u>15-01-2016</u>
DOKUMENT	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 15.01.2016, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-02-3962/15, për z. Sabit Latifi, Anëtar i Kuvendit Komunal në Mitrovicë, për shkak se zyrtari i lartë ka dhënë dorëheqje nga ushtrimi i funksionit publik për të shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Sabit Latifi, Anëtar i Kuvendit Komunal në Mitrovicë, dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Zyrtari i lartë, fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, Pas pranimin të kësaj shkrese, z. Latifi është takuar me zyrtarët e AKK – së, në këtë rast zyrtari i lartë është bindur me fakte se gjatë ushtrimit të funksionit publik nuk mund të ushtroj funksion menaxherial në biznes privat, neni 15 (paragrafi 1), të Ligjit nr.04/L-051.

Zyrtari i lartë z. Latifi ka deklaruar se brenda afatit ligjor do të ndërmarrë veprimet e nevojshme për shmangie të konfliktit të interesit.

Ndërkohë, z. Latifi ka dërguar në Agjenci një shkresë zyrtare (DPKI.03-02/55/16), në të cilën vërtetohet se zyrtari i lartë ka dhënë dorëheqje nga funksioni publik si Anëtar i Kuvendit Komunal në Mitrovicë, për të ushtruar funksionin menaxherial në biznesin e tij privat N.P.T “Bujaria”.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

